



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së parë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbajtur më 07.07.2022, e cila filloi në orën 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fiknete Bejta LDK, Arbër Vokrri VV, Liridon Selmani PDK, Taulant Maxharraj AAK, Mimoza Xhaka- Blacaku eksperete e jashtme.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fiknete Bejta**, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

Rend dite :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Miratimi i Kalendarit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
3. Informatë nga dr. Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë;
4. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kryesuesja konstatoi se njëzëri më 5 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Pika e dytë

Miratimi i Kalendarit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Fiknete Bejta, kryesuesha tha se i kamë bërë disa propozime, por ky është draft dhe mundemi me propozuar edhe diçka që ju e shihni të arsyeshme. Për këtë vit i kemi edhe 7 mbledhje dhe këtu kemi dy fusha shëndetësia dhe mirëqenia sociale.

Faqe 1 nga 3

Projektet që i takojnë Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Shëndetësisë, ne si propozim mundemi me i shtuar edhe ndonjë projekt për me e miratuar në Kuvend, pa si që në muajin shtator miratohet buxheti.

Për Handikosin, që nuk kemi arrit me shty si kauzë përpara dhe ju kemi mbetë borxh edhe si objekt edhe si subjekt, nuk kemi has në mirëkuptim në mandatin e kaluar, mendoj që në nëntor me i ftua dhe me diskutuar me ta.

Arbër Vokrri, po ashtu propozoi që në njërin nga takimet e radhës së komitetit të ftohen infermierët, higjienistët dhe në veçanti punëtorët e sigurimit kur askush nuk është marr me ta.

Fiknete Bejta, kryesues tha se në muajin tetor si pikë e rendit të ditës të jetë edhe takimi me stafin mjekësor. Ajo po ashtu ceku se ne mundemi me e nda një fond minimal për kategorinë që ka dioptri të theksuar, po nuk kanë mundësi të pajisen me syze adekuate për arsyetë të çmimit të lartë të tyre. Si komitet të propozojmë një shumë prej 5 apo 10 mijë euro për këtë kategori sociale.

Pika e tretë

Informatë nga dr. Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë

Dr. Izet Sadiku i përshëndeti të pranishmit i cili tha se formimi i komitetit ka me qenë i rëndësishme, për arsyetë se përmes këtij komiteti, do të jetë një interes i dyanshëm me qëllim me i forcuar institucionet shëndetësore dhe shërbimet që jepen ndaj qytetarëve, pra njëkohësisht duke e pasur parasysh edhe me i mbrojt edhe punëtorët shëndetësor.

Drejtoria e Shëndetësisë për veç që ka në mbikëqyrje zhvillimin e mjekësisë primare, kjo drejtori e ka për obligim edhe krijimin e institucioneve të shëndetësisë sekondare.

Sipas Ligjit të kryeqytetit, nen 7, pika 7.1, thuhet se Prishtina e themelon spitalin e qytetit Sa i përket vizitave mjekësore në gjashtëmuajorin e parë kanë qenë 503 mijë vizita mjekësore, që do të thotë 10% më shumë se 6 mujori i viti të kaluar, ndërsa numri i shërbimeve me vizita, me shërbime mjekësore për këta 6 muaj është 2 milionë e 600 mijë shërbime.

Arbër Vokrri kërkoi të dijë se sa punëtor shëndetësor i kemi, sa mjek dhe sa infermier.

Izet Sadiku, drejtor tha se janë më se 847 punëtorë shëndetësor. Ne kemi shumë mjek në Prishtinë përveç mjekëve familjarë kemi edhe mjek të shërbimeve të tjera, si pediatër, oftamolog etj.

Ne do ta rrisim bashkëpunimin këtu të brendshëm në institucionet dhe besoj 6 mujori i ardhshëm përveç këtyre punëve do të jetë fazë ku ne do të hymë në krijimin e institucioneve sekondare, hapi i parë që ne jemi duke e bërë jemi duke e bërë me poliklinikën stomatologjike.

Liridon Selmani tha se ne duhet ti shfrytëzojmë kompetencat që i jep Ligji për Prishtinën dhe të fillojmë ta shtyjmë krijimin e spitalit, sepse do ti ndihmonte pacientët e Prishtinës mos të drejtohen në një institucion terciar të shërbimeve, kështu që krijimi i spitalit është më se i domosdoshëm dhe njëra prej arsyeve përsë unë jam kyç në asamble ka qenë që me shty këtë si ide në themelimin e këtij spitali.

Faqe 2 nga 3

gjithë ne e kemi pasur si prioritet gjatë fushatës dhe patjetër që duhet me e mbështetë dhe çka do që

ka nevojë në Kuvend Komunal, por edhe më tutje ku kemi mundësi. Në vazhdim ceku se do të ishte mirë me i bërë presion Qeverisë, që me e rrit numrin e personelit dhe me shikuar se si po shkon shpërndarja e punës, se kam përshtypjen që disa ndërrime ngarkohen, punojnë më shumë se disa tjera. Gjithashtu do duhej funksionalizuar shërbimin e rentgenit ne QMF IV, që ende nuk është aktiv. Në disa qendra mjekësore mungojnë barnat esenciale, mungojnë disa gjëra të tjera që janë shumë të nevojshme për pacientët.

Lidhur me disa çështje të tjera të ngritura nga z. Vokrri, sqarime shtesë dha Izet Sadiku, drejtor.

Fiknete Bejtë, kryesuese tha se shëndetësia ka shumë probleme, ne duhet me kontribuar si komitet aq sa kemi mundësi

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesja e komitetit
Fiknete Bejtë



Faqe 3 nga 3